

**OSHEE GROUP sh.a** njofton mbi hapjen e vendit vakant **Shef Sektori** pranë OSSH / Departamenti i Kontrollit dhe Rekuperimit të Humbjeve / Drejtoria e Kontrollit dhe Analizës / Sektori i Raportimit dhe Analizës.

## **SHEF SEKTORI**

Shefi i Sektorit të Raportimit dhe Analizës është përgjegjës për analizimin e të dhënave, identifikimin e anomalive dhe parregullsive, monitorimin e performancës së departamentit dhe hartimin e raporteve analitike, me qëllim mbështetjen e vendimmarrjes, optimizimin e proceseve të kontrollit dhe rritjen e efektivitetit të rikuperimit të humbjeve.

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Analizon të dhënat e transaksioneve dhe konsumit të energjisë për identifikimin e anomalive dhe parregullsive.
- Përdor modele statistikore, metoda analitike dhe mjete të avancuara për zbulimin e rasteve me risk të lartë.
- Ofron lista prioritare dhe rekomandime për kontrole në terren.
- Krijon dhe mirëmban panele kontrolli (dashboards) për monitorimin në kohë reale të performancës së departamentit.
- Ndjek tregues kryesorë si: niveli i humbjeve, shumat e rikuperuara, kohëzgjatja e procesit të rikuperimit dhe performanca sipas zonave.
- Identifikon zona me performancë të ulët dhe propozon masa për përmirësim.
- Harton raporte periodike analitike për menaxhimin dhe autoritetet përkatëse.
- Siguron saktësinë, koherencën dhe transparencën e të dhënave të raportuara.
- Përgatit analiza krahasuese dhe raporte trendesh.
- Analizon efektivitetin e proceseve ekzistuese të kontrollit dhe rikuperimit.
- Propozon strategji dhe masa për përmirësimin e proceseve bazuar në të dhëna dhe analiza.
- Mbështet vendimmarrjen menaxheriale me analiza të strukturuar.
- Kontribuon në zhvillimin dhe përmirësimin e sistemeve të menaxhimit të humbjeve.
- Bashkëpunon me strukturat e IT-së për automatizimin e raportimit dhe analizës së të dhënave.
- Siguron që sistemet të mbështesin mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të sakta.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

**Kualifikimet dhe kërkesat:**

- Arsim i lartë në inxhinieri, ekonomi, informatikë, statistikë ose fusha të ngjashme.
- Jo më pak se 3 vite eksperiencë pune në menaxhim, kontroll, analizë ose sektorin energjetik.
- Aftësi të forta analitike, organizative dhe drejtuese.
- Njohuri mbi analiza të të dhënave, raportim dhe përdorimin e sistemeve analitike.
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe bashkëpunimi ndërsektorial.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.